



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve  
Centralna Izborna Komisija  
Central Election Commission



**KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**, në pajtim me autorizimet e dhëna me nenin 63, nenin 82 Ligjit Nr.08/L-228, për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, nenin 7 paragrafi 3 të Rregullores Zgjedhore Nr.03/2024 Krijimi, Kundërshtimi dhe Konfirmimi i Listës së Votuesve, në mbledhjen e rregullt të mbajtur me datën 09.04.2024, nxjerr këtë:

## VENDIM

**Për miratimin e Rekomandimit për Rritjen e Numrit të Votuesve për Vendvotime, për procesin e votimit për apo kundër largimit të kryetarëve të komunave Leposaviq, Zubin Potok, Zveqan dhe Mitrovicë e Veriut**

- I. Miratohet Rekomandimi për Rritjen e Numrit të Votuesve për Vendvotime, për procesin e votimit për apo kundër largimit të kryetarëve të komunave Leposaviq, Zubin Potok, Zveqan dhe Mitrovicë e Veriut, që do të mbahet me datën 21 prill 2024.
- II. Numri i votuesve rritet nga 750 votues deri në 950 votues në një vendvotim.
- III. Rekomandimi si në pikën I, është pjesë përbërëse e këtij vendimi.
- IV. Obligohet Sekretariati i KQZ për zbatimin e këtij vendimi.
- V. Ky vendim, hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Prishtinë, 09.04.2024

Kryesues

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve

  
Kreshnik Radoniqi



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve  
Centralna Izborna Komisija  
Central Election Commission



<i>Data</i>	09.04.2024
<i>Për</i>	Këshillin për Operacione Zgjedhore
<i>Nga</i>	Burim Ahmetaj - Kryeshef Ekzekutiv i Sekretariatit të KQZ-së
<i>Lënda</i>	Rekomandim për rritjen e numrit të votuesve për vendvotime për procesin e votimit për apo kundër largimit të kryetarëve të komunave Leposaviq, Zubin Potok, Zveçan dhe Mitrovicë e Veriut, që do të mbahen me datën 21 prill 2024.

Të nderuar Anëtarët të Këshillit për Operacione Zgjedhore ,

Në mbështetje të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, neni 82, paragrafi 1, asnjë vendvotim brenda Qendrës së Votimit nuk tejkalon numri 750 votues, Përjashtimet nga kjo rregull mund të autorizohen nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve.

Duke qenë se jemi në fazën finale të krijimit të listës së votuesve, gjegjësisht në caktimin e votuesve për vendvotime në bazë të renditjes alfabetike, për arsye të kapaciteteve që kanë qendrat e votimit në posedimin e hapësirave/ klasave që mund të shfrytëzohen si vendvotime, kufizimit të shpenzimeve dhe duke u bazuar në vendimet e marra në proceset e kaluara zgjedhore, rekomandojmë Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për marrjen e vendimit për rritjen e numrit të votuesve për vendvotime deri në 950 votues për vendvotim.

I. Numri i vendvotimeve deri në 750 votues është: 87 vendvotime.

II. Numri i vendvotimeve deri në 950 votues është: 73 vendvotime.

Po që se do të kalkulohej me numër të votuesve për vendvotim, deri në 750 votues, i bie që do të shtoheshin 14 vendvotime më shumë.

*Tabelë 1: Numri i votuesve për qendra të votimit, me llogaritjen deri 950 votues për vendvotim dhe deri në 750 votues për vendvotim.*

<b>Kodi Komunēs</b>	<b>Qendra Votimit</b>	<b>Numri Votuesve</b>	<b>Numri Vendvotimeve (950)</b>	<b>Numri Vendvotimeve (750)</b>
12	1201	2584	3	4
12	1202	1703	2	3
12	1203	2350	3	4
12	1204	920	1	2
12	1205	350	1	1
12	1206	2727	3	4
12	1207	63	1	1
12	1208	302	1	1
12	1209	485	1	1
12	1210	107	1	1
12	1211	197	1	1
12	1212	156	1	1
12	1213	350	1	1
12	1214	336	1	1
12	1215	214	1	1
12	1216	80	1	1
12	1217	442	1	1
12	1218	308	1	1
28	2801	2706	3	4
28	2802	269	1	1
28	2803	357	1	1
28	2804	406	1	1
28	2805	378	1	1
28	2806	211	1	1
28	2807	420	1	1
28	2808	623	1	1
28	2809	906	1	2
28	2810	125	1	1
28	2811	387	1	1
28	2812	89	1	1
29	2901	4024	5	6
29	2902	246	1	1
29	2903	204	1	1
29	2904	650	1	1
29	2905	1368	2	2
29	2906	717	1	1
38	3801	936	1	2
38	3802	1392	2	2
38	3803	1228	2	2
38	3804	160	1	1
38	3805	9253	10	13
38	3806	5034	6	7
38	3807	793	1	2
		<b>46,556</b>	<b>73</b>	<b>87</b>



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve  
Centralna Izborna Komisija  
Central Election Commission



**KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**, në pajtim me autorizimet e dhëna me nenin 7, nenin 8, nenin 63, nenin 64 paragrafi 2.7 të Ligjit Nr.08/L-228, për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, nenin 7 të Rregullores Zgjedhore Nr.03/2024 Krijimi, Kundërshtimi dhe Konfirmimi i Listës së Votuesve, në mbledhjen e rregullt të mbajtur me datën 09.04.2024, nxjerr këtë:

## VENDIM

### Për Certifikimin e Listës Përfundimtare të Votuesve, për procesin e votimit për apo kundër largimit të kryetarëve të komunave Leposaviq, Zubin Potok, Zveqan dhe Mitrovicë e Veriut

- I. Certifikohet Lista Përfundimtare e Votuesve, për procesin e votimit për apo kundër largimit të kryetarëve të komunave Leposaviq, Zubin Potok, Zveqan dhe Mitrovicë e Veriut, që do të mbahet me datën 21 prill 2024.
- II. Lista Përfundimtare e Votuesve sipas këtij vendimi është publike, dhe do të shpallet në ueb-faqen e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
- III. Raporti i Listës Përfundimtare të Votuesve, është pjesë përbërëse e këtij vendimi.
- IV. Obligohet Sekretariati i KQZ për zbatimin e këtij vendimi.
- V. Ky vendim, hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Prishtinë, 09.04.2024

Kryesues  
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve  
  
Kreshnik Radoniqi



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Komisioni Qendror i Zgjedhjeve*  
*Centralna Izborna Komisija*  
*Central Election Commission*



**PROCESI I VOTIMIT PËR APO KUNDËR LARGIMIT TË  
KRYETARËVE TË KOMUNAVE LEPOSAVIQ, ZUBIN  
POTOK, ZVEÇAN DHE MITROVICË E VERIUT  
21.04.2024**

**Lista Votuese**

**2024**

## **Përmbajtja**

1.	Qëllimi .....	3
2.	Përmbledhje .....	3
3.	Përshkrimi .....	4
4.	Periudha e Shërbimit të Votuesve .....	4
5.	Kërkesa për Këshillin Gjyqësor të Kosovës .....	5
6.	Periudha e Kundërshtimit dhe Konfirmimit të Listës Votuese .....	5
7.	Periudha e regjistrimi të votuesve jashtë Kosovës .....	5
8.	Krijimi i Listës Votuese .....	6
9.	Përmbledhje tabelore .....	6

## 1. Qëllimi

Në bazë të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) është i obliguar që të certifikoj listën e votuesve në raport me zgjedhjet e caktuara<sup>1</sup>.

Ky dokument e mbështetë procesin e certifikimit të listës së votuesve për Procesin e votimit për apo kundër largimit të kryetarëve të komunave Lepasaviq, Zubin Potok, Zveçan dhe Mitrovicë e Veriut, që do të mbahet me datë 21.04.2024.

## 2. Përmbledhje

Lista Votuese (LV) për Procesin e Votimit, 21.04.2024, bazohet në Ekstraktin e Regjistrimit Qendror Civil. Ky ekstrakt është përpiluar nga departamentet e Agjencisë së Regjistrimit Civil (ARC), Departamenti i Gjendjes Civile dhe Departamenti i Prodhimit të Dokumenteve, në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme.

LV për procesin e votimit për apo kundër largimit të kryetarëve të komunave Lepasaviq, Zubin Potok, Zveçan dhe Mitrovicë e Veriut, përmban:

- **46,556** votues, me dallim prej **1,461** votues më shumë, në krahasim me Zgjedhjet e jashtëzakonshme për komunat: Mitrovicë e Veriut, Zubin Potok, Lepasaviq dhe Zveçan, të mbajtura me 23.04.2023.
- I. Numri i Qendrave të Votimit (QV) është **dyzet e tre (43)**.
- II. Numri i vendvotimeve është **shtatëdhjetë e tre (73)**.

---

<sup>1</sup> Ligji Nr. 08/L-228, Për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, Neni 64, nënparagrafi (2.8).

### 3. Përshkrimi

Pas pranimit të ekstraktit nga Regjistri Qendror Civil, Divizioni i Shërbimit të Votuesve, ka bërë caktimin e votuesve në qendra të votimit.

Numri i votuesve të rinj që do të votojnë për herë të parë në procesin e votimit për apo kundër largimit të kryetarëve të komunave Leposaviq, Zubin Potok, Zveçan dhe Mitrovicë e Veriut, me datën 21.04.2024, është: **1,826** votues.

- a) **293 votues** të rinj që pas Zgjedhjet e jashtëzakonshme, të mbajtura me datën 23.04.2023, kanë arritur moshën tetëmbëdhjetë (18) vjeç dhe do të votojnë për herë të parë në procesin e votimit për apo kundër largimit të kryetarëve të komunave Leposaviq, Zubin Potok, Zveçan dhe Mitrovicë e Veriut.
- b) **1,533 votues** që nuk kanë qenë në Listën e Votuesve në Zgjedhjet e jashtëzakonshme, të mbajtura me 23.04.2023, e që mund të konsiderohen si votues të regjistruar për herë të parë në RQC apo votues të cilët kanë ndërruar komunën pas zgjedhjeve të jashtëzakonshme, 23.04.2023.

Numri i votuesve që janë larguar si të vdekur, kanë ndërruar komunën apo që kanë hequr dorë nga shtetësia e Republikës së Kosovës, pas Zgjedhjeve të jashtëzakonshme të datës 23.04.2023, për komunat: Leposaviq, Zubin Potok, Zveçan dhe Mitrovicë e Veriut është: **365**.

### 4. Periudha e Shërbimit të Votuesve

Periudha e Shërbimit të Votuesve ka filluar me datën 18 mars 2024 dhe ka përfunduar me datën 3 prill 2024.

Gjatë kësaj kohe, të gjithë votuesit kanë pasur mundësi të informohen për qendrën e votimit ku janë caktuar dhe të kërkojnë ndërrimin e qendrës së votimit.

Numri i kërkesave për ndërrimin e qendrave të votimit është: **12**.

- a) **4** kërkesa për ndërrim të qendrës së votimit janë parashtruar përmes platformës elektronike të KQZ-së.
- b) **8** kërkesa për ndërrim të qendrës së votimit janë parashtruar në zyrat e Komisionit Komunal Zgjedhor, përmes formularëve për ndërrim të qendrave të votimit.

Të gjitha kërkesat për ndërrim të qendrës së votimit janë aprovuar.



Pas kësaj periudhe, Divizioni i Shërbim të Votuesve ka vendosur të gjitha ndryshimet në listën e votuesve, e cila më pas është integruar në ekstraktin e fundit që është pranuar nga Agjencia e Regjistrimit Civil.

## **5. Kërkesa për Këshillin Gjyqësor të Kosovës**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, me datën 8 mars 2024 ka dorëzuar kërkesën në Këshillin Gjyqësor të Kosovës (KGJK), me qëllim të pajisjes me të dhëna e qytetarëve që u është marrë zotësia e veprimit.

Nga KGJK kemi pranuar të dhënat për tetë (8) persona që ju është marrë zotësia e veprimit.

Pas verifikimit të personave me të dhënat e Ekstraktin e RQC, nga lista e votuesve kemi larguar vetëm tre (3) persona (dy persona nga komuna e Mitrovicës së Veriut dhe një person nga komuna e Zubin Potokut). Ndërsa, pesë (5) persona të tjerë nuk kemi arritur ti identifikojmë për arsye se janë dërguar pa numër personal dhe pa datë të lindjes, rrjedhimisht nuk mund të identifikohen në bazën e të dhënave.

## **6. Periudha e Kundërshtimit dhe Konfirmimit të Listës Votuese**

Periudha e Kundërshtimit dhe Konfirmimit e Listës së Votuesve ka filluar me datën 18 mars 2024 dhe ka përfunduar me datën 5 prill 2024.

Përgjatë kësaj periudhe nuk ka pasur asnjë rast të kundërshtimit të listës së votuesve.

## **7. Periudha e Regjistrimi të votuesve jashtë Kosovës**

Periudha e Regjistrimi të Votuesve jashtë Kosovës ka filluar me datën 29 mars 2024 dhe ka përfunduar me datën 5 prill 2024.

Shtetasit të cilët jetojnë jashtë Kosovës përgjatë kësaj periudhe kanë pasur mundësi të regjistrohen përmes platformës elektronike dhe përmes postës.

Përgjatë periudhës së aplikimit për regjistrim, përmes platformës elektronike, janë pranuar **2 kërkesa për regjistrim**, të cilat janë aprovuar dhe të njëjtat janë informuar lidhur me statusin e aplikimit. Ndërsa përmes kutisë postare nuk ka pasur asnjë dërgesë postare.

2 votuesit e regjistruar suksesshëm për votim jashtë Kosovës janë larguar nga lista e votuesve brenda Kosovës.

## 8. Krijimi i Listës së Votuesve

Pas përfundimit të Periudhës së Shërbimit të Votuesve, Periudhës së Regjistrimit për Votim jashtë Kosovës. Periudhës së Kundërshtimit dhe Konfirmimit të LV-së, Divizioni për Shërbim të Votuesve i ka caktuar votuesit nëpër vendvotime sipas renditjes alfabetike. Të dhënat janë shtypur në format PDF dhe kualiteti është kontrolluar nga ana e Divizionit të Shërbim të Votuesve.

Këto dokumente janë të gatshme për t'ju dërguar operatorit ekonomik, i cili do të bëjë shtypjen e Listës së Votuesve.

## 9. Përmbledhje tabelore

Tabela 1. Numri i votuesve, Numri i Qendrave të Votimit dhe Numri i Vendvotimeve për komunat e Leposaviq, Zubin Potok, Zveçan dhe Mitrovicë e Veriut.

<b>Kodi Komunal</b>	<b>Komunat</b>	<b>Numri i votuesve për komuna</b>	<b>Numri i Qendrave të Votimit</b>	<b>Numri i Vendvotimeve</b>
12	Leposaviq	13,674	18	25
28	Zubin Potok	6,877	12	14
29	Zveçan	7,209	6	11
38	Mitrovicë e Veriut	18,796	7	23
	<b>TOTALI</b>	<b>46,556</b>	<b>43</b>	<b>73</b>



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve  
Centralna Izborna Komisija  
Central Election Commission



**KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**, në pajtim me autorizimet e dhëna me nenin 63 dhe 64 paragrafi 2.1, nenin 101 paragrafi 1 të Ligjit Nr.08/L-228, për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, neni 8 paragrafi 6 i Rregullores Zgjedhore Nr. 12/2024 Votimi, Numërimi në Vendvotim dhe Menaxhimi i Vendvotimit, si dhe nenin 10 paragrafi 6.6 të Rregullores Zgjedhore Nr.11/2024 Këshillat e Vendvotimeve, në mbledhjen e rregullt të mbajtur me datën 09.04.2024, nxjerr këtë:

## VENDIM

### Për miratimin e Procedurës për Regjistrimin me Kamera Vëzhguese në Vendvotime

- I. Miratohet Procedura për Regjistrimin me Kamera Vëzhguese në Vendvotime.
- II. Procedura si në piken I, është pjesë përbërëse e këtij vendimi.
- III. Obligohet Sekretariati i KQZ për zbatimin e këtij vendimi.
- IV. Ky vendim, hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Prishtinë, 09.04.2024

Kryesues

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve



Kreshnik Radoniqi



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
*Komisioni Qendror i Zgjedhjeve*  
*Centralna Izborna Komisija*  
*Central Election Commission*



# Procedura për regjistrimin me kamera vëzhguese në vendvotime

## Përmbajtja

1	Qëllimi.....	3
2	Ligjshmëria dhe domosdoshmëria .....	3
3	Transparenca dhe informimi.....	4
4	Siguria dhe ruajtja e të dhënave.....	4
5	Kërkesa bazë të regjistrimit të kamerave .....	4
6	Karakteristikat teknike të regjistrimit.....	4
7	Procedura Standarde e Operimit .....	5
7.1	Përgatitjet para ditës së votimit .....	5
7.2	Përdorimi i kamerave në vendvotim .....	5
7.2.1	Përpara hapjes së procesit të votimit:.....	5
7.2.2	Pas përfundimit të procesit të votimit:.....	6
8	Angazhimi i Operatorit Ekonomik për instalimin dhe përkrahjen teknike...	6
9	Qasja në regjistrimet e kamerave .....	7
9.1	Kërkesat për qasje në regjistrime.....	7
9.2	Personat përgjegjës .....	7

## 1 Qëllimi

Vendosja e kamerave vëzhguese në hapësirat brenda vendvotimit bëhet me qëllim të garantimit të sigurisë së materialeve të ndjeshme dhe ruajtjes së integritetit të procesit të votimit dhe numërimit, në vendvotim.

## 2 Ligjshmëria dhe domosdoshmëria

Sipas vlerësimeve të KQZ-së, në ditën e zgjedhjeve, në qendra të votimit përkatësisht në vendvotime, në proceset zgjedhore nga vitit 2009 deri në vitin 2021 kishte parregullsi të cilat ndikuan në integritetin, koston dhe besimin e publikut në zgjedhje.

Në proceset zgjedhore 2009-2021 mesatarisht janë rinumëruar 36 % e vendvotimeve. Rinumërimi ndikoi në rritjen e koston së zgjedhjeve dhe rënien e besimit të akterëve në administrimin e procesit zgjedhor.

Që nga viti 2009 si rezultat i parregullsive në ditën e votimit, KQZ u detyruar të përsëris votimin në disa komuna. Në vitin 2011, pas konstatimit të parregullsive në ditën e zgjedhjeve të datës 12.12.2010, votimi është përsëritur në komunat Skenderaj, Drenas, Deçan, Malishevë, Lipjan dhe Mitrovicë. Në vitin 2013 në komunën e Mitrovicës së Veriut në ditën e zgjedhjeve në tri qendra të votimit janë dëmtuar kutitë e votimit duke detyruar KQZ-në që të përsërisë procesin e votimit. Në të njëjtin vit në komunën e Parteshit në një qendër të votimit poashtu janë dëmtuar kutitë e votimit që rezultoi me përsëritjen e zgjedhjeve në këtë qendër. Në vitin 2017, në zgjedhjet lokale në komunën e Parteshit, pas një ankese, PZAP ka marrë vendim për përsëritjen e votimit në tri qendra të votimit për shkak të minimumit të integritetit të procesit të votimit në ditën e zgjedhjeve.

Duke u bazuar në këto argumente, në pajtim me autorizimet e dhëna me nenin 63 dhe 64 paragrafi 2.1, nenin 101 paragrafi 1 të Ligjit Nr.08/L-228, për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, neni 8 paragrafi 6 i Rregullores Zgjedhore Nr. 12/2024 Votimi, Numërimi në Vendvotim dhe Menaxhimi i Vendvotimit, si dhe nenin 10 paragrafi 6.6 të Rregullores Zgjedhore Nr.11/2024 Këshillat e Vendvotimeve, KQZ konsideron se me qëllim të ruajtjes së integritetit të procesit të votimit dhe numërimit dhe me qëllim të krijimit të një mjedisi për të siguruar se liria dhe fshehtësia e votës është e garantuar, vëzhgimi me kamera do të ndikojë pozitivisht në administrimin e procesit të votimit.

### **3 Transparenca dhe informimi**

KQZ do të vendosë shënjes në hyrje të çdo qendre të votimit ku votuesit njoftohen se procesi i votimit dhe numërimit në vendvotim regjistrohet me kamera. Gjithashtu, KQZ do ti njoftojë përmes njoftimeve publike se procesi i votimit dhe numërimit në vendvotime do të regjistrohet me kamera. Anëtarët e Këshillave të vendvotimeve do të njoftohen gjatë seancave të trajnimit në lidhje me regjistrimin. Ndërsa vëzhguesit e akredituar do të njoftohen në momentin kur KQZ të bëjë akreditimin e tyre.

### **4 Siguria dhe ruajtja e të dhënave**

Regjistrimi në vendvotim, përkatësisht vendosja e kamerave, bëhet duke respektuar fshehtësinë e votës. Pra, kamera vendoset në skajin tjetër të vendit ku duhet të vendoset kabina e votimit, në mënyrë që votuesi të shënojë preferencat pa u regjistruar nga kamera.

Regjistrimet do të jenë pasive dhe do të ruhen në kartela të memories. Regjistrimet e ruajtura në kartela të memories do të enkriptohen përmes një algoritmi të enkriptimit që pamundëson leximin e të dhënave pa kredencialet për qasje.

Pas grumbullimit të kamerave në objektin e KQZ-së, regjistrimet nxirren nga kamerat dhe bartën në një pajisje apo medium (disk) që nuk është i qasshëm përmes internetit dhe pajisja do të vendoset në një vend të sigurt me qasje të kufizuar, në kushte të njëjta me serverët e KQZ-së. Qasja në pajisje apo medium duhet të bëhet duke aplikuar autorizimin përmes kredencialeve, si emrin e llogarisë dhe/ose fjalëkalimin. Kohëzgjatja e ruajtjes së regjistrimeve të kamerave do të jetë gjashtëdhjetë ditë, përveç regjistrimeve nga vendvotimet të cilat janë objekt i hetimit nga organet kompetente.

### **5 Kërkesa bazë të regjistrimit të kamerave**

- a) Kamerat duhet të realizojnë regjistrimin e procesit të votimit në VV për procesin e votimit të datës 21.04.2024.
- b) Kamera duhet vendosur në pozicionin e kundërt me kabinën e votimit në VV.
- c) Kamerat duhet të kenë mundësi regjistrimi video për një kohë minimale prej 14 ore.
- d) Kamerat e regjistrimit duhet të kenë një pavarësi nga energjia elektrike për të paktën 2 ore.

### **6 Karakteristikat teknike të regjistrimit**

- a) Regjistrimi me kamera nuk përfshinë regjistrimin e zërit dhe nuk ka shënjim kohor.
- b) Regjistrimi ruhet në medium lokal (SD kartelë) dhe nuk transmetohet përmes çfarëdo rrjete lokale apo në internet.

- c) Kapaciteti i ruajtjes se informacionit video ne memorien SD karte nuk duhet te jete me pak se 128GB. Karta e memories SD te jete e instaluar ne çdo kamera.
- d) Parametra minimal për kamerat: cilësia video te jete me rezolucion te larte pamje video, këndi i pamjes minimumi 90°.
- e) Kamerat duhet te vendosen ne një lartësi prej jo me pak se 220 cm dhe jo me shume se 270 cm nga dyshemeja.
- f) Çdo bllok ushqimi duhet te pajisjet me bateri për kamerën, ne mënyrë qe te vazhdoje te regjistroje te paktën 120 minuta ne rast mungese te energjisë elektrike.
- g) Te gjitha imazhet e marra nga kamerat duhet te regjistrohen ne formë digjitale gjatë gjithë procesit të votimit.
- h) Regjistrimet video duhet të kryen me rezolucionin te paktën 1920×1080 piksela, (Full High-Definition).
- i) Regjistrimet e enkriptuara në kartelë të memories dhe mund të nxirren vetm mbrojtura dhe vetëm me lidhjen e kamerës përmes kabllor të mund të nxirret shënimi.

## **7 Procedura Standarde e Operimit**

### **7.1 Përgatitjet para ditës së votimit**

Për secilin vendvotim përgatitet një set i kamerës dhe pajisjeve përcjellëse

- a) Strukturë me baze metalike dhe bosht te lëvizshëm qe mundëson ngritjen e kamerës ne lartësinë e nevojshme;
- b) Kamera vëzhguese
- c) Kartelë memorie Ultra microSDXC 128GB
- d) Bllok ushqimi 13,8V 3A
- e) Bateri e karikueshme 12V-7.2AH ;
- f) Spinë 220V;
- g) Zgjatues korrenti (3m)l;
- h) Fishë ushqimi për kamerën
- i) Afishe (ngjitëse) në të cilat shënohen udhëzimet për përdorim dhe numri i vendvotimit.

### **7.2 Përdorimi i kamerave në vendvotim**

#### **7.2.1 Përpara hapjes se procesit te votimit:**

- a) Kryesuesi verifikon nëpërmjet ngjitësit të vendosur tek koka e kamerës, boshti i mbajtësit dhe kutia e baterisë vendvotimin.
- b) E pozicionon kamerën në vendin e caktuar me ndihmën e anëtarëve të KVV-së.
- c) Ngre lart shulin e mbajtësit dhe e fikson në mënyrë që kamera të monitorojë ambientin e vendvotimit.



- d) Pozicionon dhe fikson syrin e kamerës nga ambienti i vendvotimit.
- e) Vendos në prizë furnizuesin me energji elektrike dhe konfirmon dritën jeshile tek kutia e baterisë.
- f) Realizon lidhjen e kamerës me ushqyesin.
- g) Shikon dritën e kuqe që ndizet tek kamera.
- h) Nga ky moment kamera fillon regjistrimin.

#### 7.2.2 Pas përfundimit të procesit të votimit:

- a) Kryesuesi i KVV shkëput kamerën nga ushqyesi me energji.
- b) Heq nga priza dhe shkëput nga rrjeti elektrik kutinë e baterisë.
- c) E ul shulin e mbajtësit të kamerës.
- d) Kamerën bashkë me materialet e tjera të ndjeshme transportohet në depo.

### 8 Angazhimi i Operatorit Ekonomik për instalimin dhe përkrahjen teknike

Me qëllim të funksionalizimit të kamerave dhe pajisjeve përcjellëse, përkrahjes në ditën e zgjedhjeve dhe nxjerrjen e regjistrimeve, KQZ kontraktin Operatorë Ekonomik ( më tej OE) që kryen këto shërbime:

- a) Instalimin dhe funksionalizimin i sistemit të kamerave, i përbërë nga kamera, SD kartela (që furnizohet nga OE), blloku i furnizimit, bateria rimbushëse, kablllo furnizimi me rrymë, kabllot e furnizimit të kamerës dhe të gjitha këto të montuara në mbajtësin metalik dhe si set të jetë i konfiguruar dhe i gatshme për përdorim.
- b) Testimi i funksionalitetit dhe regjistrimit në kartelë të memories para shpërndarjes në teren.
- c) Përkrahja teknike në teren në ditën e votimit (21 prill) ku OE duhet të sigurojë evitimin e problemit apo zëvendësimin e pajisjes së dëmtuar/ jo funksionale gjatë procesit të votimit, për jo më shumë se 1 orë nga njoftimi. OE duhet të sigurojë operatorët e nevojshëm për të pranuar thirrje telefonike në rast problemesh me kamerat e regjistrimit.
- d) Kompania duhet të sigurojë nxjerrjen e pamjeve filmike (video) pas mbarimit të procesit të votimit për një kohë jo më të vonë se 1 javë pas mbylljes së procesit të votimit, dhe ruajtjen e tyre në mediumin memorues adekuat, të siguruar nga KQZ (tip NAS storage apo ekuivalent), por për ndonjë rast specifik, sigurimi/eksportimi i pamjeve duhet të bëhet nga OE/GOE brenda 24h në rast nevojë, që rrjedhë si rezultat i ndonjë ankese në ndonjë qendër votimi ose të ngjashme.

E gjithë puna e punonjësve të kompanisë së kontraktuar do të bëhet vetëm në prezencën e Zyrtarit përgjegjës nga KQZ.

## **9 Qasja në regjistrimet e kamerave**

### **9.1 Kërkesat për qasje në regjistrime**

Pamjet e regjistruara me kamerat e sigurisë në vendvotime, do të vihen në dispozicion pas autorizimit me shkrim nga Drejtori i SKQZ-së, si rezultat i kërkesës nga PZAP apo ndonjë autoritet për zbatimin e ligjit.

### **9.2 Personat përgjegjës**

Zyrtari i Lartë për Teknologji Informative dhe Zyrtari i Lartë për Bazën e të dhënave kanë qasje në pajiset për regjistrimin dhe kontrollin e kamerave. Vetëm në mungesë të tyre qasje mund të ketë edhe Drejtori i DTI-së. Për qëllime të ruajtjes së regjistrimeve, mirëmbajtjes dhe evitimin e problemeve, qasje mund të kenë edhe personat përgjegjës të operatorëve ekonomik.